



Nr.6

ISSN 2521-831X

BULETINI MUJOR

KLIMATIK

Qershor 2017



Universiteti Politeknik i Tiranës

Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit & Mjedisit

Tirana © 2017



BULETINI MUJOR


KLIMATIK

QERSHOR 2017
Nr. 6

Vlerësimi meteorologjik për muajin qershor 2017

Muaji qershor 2017, në tërësi u karakterizua nga mbizotërimi i masave ajrore anticiklonare, shoqëruar me mot të qëndrueshëm në pjesën më të madhe të kohës dhe me temperatura mesatare të ajrit mbi normë. Vetëm 2 deri 4 ditë u karakterizuan me reshje të pakta kryesisht me natyrë lokale në brendësi të vendit. Ndërkohë, duke pasur në konsideratë kushtet fiziko gjeografike të vendit tonë, orientimin e relievit, veçanërisht të zonave kodrinore e vargmaleve; reshjet e vërtetuar gjatë muajit qershor më shumë ishin të lokalizuara apo thënë ndryshe të favorizuara si rrjedhojë e ndikimit të kushteve orografike, se sa nga ndikimi i masave ajrore dhe sistemeve frontale, që kaluan mbi hapësirën e vendit tonë. Kjo reflektohet dhe pasqyrohet dhe nga produktet e modeleve të ndryshme si p.sh., ai i Aladinit, ku në figurën Nr.1 jepet parashikimi i reshjeve për 24 orët në vijim për datën 5.06.2017. Siç shihen në të, dukshëm dallohen zona të vogla të pikëzuara me ngjyrë blu deri në të kuqe, ku parashikoheshin reshje deri në 20-50 mm në 24 orë, kryesisht me natyrë lokale; ndërsa në Ulëtisrën Perëndimore nuk priten reshje.


Figura Nr.1 – Parashikimi i reshjeve për 24 orët në vijim më datë 5.06.2017 ora 6 UTC.



Pjesa tjetër e muajit siç u theksua më lart u karakterizua nga mbizotërimi i ndikimit të sistemeve anticiklonare mbi hapësirën e vendit tonë duke përcjellë mot të qëndrueshëm e pa reshje, me temperatura të ajrit me një tendence në rritje, të cilat në fund të muajit qershor shënuan vlerat më të larta. Disa prej maksimumeve të temperaturave të ajrit ishin +35.8°C në Tiranë, **+41.5°C** në Peqin, +39.6°C në Belsh dhe +39.2°C në Orikum. Për rrjedhojë në pjesën e dytë të muajit filluan të theksohen dukuritë e thatësisë apo zjarreve në pyje. Ndërkohë, pjesa qendrore e kontinentit Europian pati mot me vranësira dhe reshje intensive.

Më datë 21 qershor u shënuar dhe solstici i verës. Në këtë datë shënohet dhe kohëzgjatja më e madhe e ditës, p.sh., për Tiranën ajo ishte: 15^h:09':48'', ku lindja e Diellit u shënuar në orën 05:07' dhe perëndimi në orën 20:17'.


Vlerësime për ecurinë e temperaturës së ajrit dhe reshjet (figurat në vijim Nr. 2/1÷2/12) në disa prej vendmatjeve meteorologjike të Sistemit Kombëtar të Monitorimit Meteorologjik për muajin qershor 2017.



KARAKTERISTIKAT KRYESORE KLIMATIKE TË MUAJIT: QERSHOR 2017

Nga pikëpamja klimatike muaji qershor 2017 dallon për prezencën në rritje të thatësirës dhe zjarreve në pyje, rrjedhje të temperaturave të larta të ajrit, të cilat në të gjithë vendin ishin mbi normë. Ndërkohë, mungesa e reshjeve dukshëm evidentohet në të gjithë tërësinë e stacioneve meteorologjike, të dhënat e të cilave u përftuan nga Sistemi Kombëtar i Monitorimit Meteorologjik. Pas kontrollit, verifikimit dhe përpunimit të të dhënave, në bazë të metodologjive respektive shkencore, disa prej rezultateve janë paraqitur në figurat Nr. 2/1÷2/12 dhe Nr. 3,4,5 dhe 6.

Figura Nr. 3. – Të dhëna për temperaturën mesatare mujore të ajrit për muajin qershor në 6 vitet e fundit dhe krahasimi me vlerat e normës për vendmatjen meteorologjike të Tiranës.



Të dhënat meteorologjike të përpunuara për disa vendmatje të përzgjedhura tregojnë për një temperaturë mesatare të ajrit rreth **+3°C** më shumë se norma në mbarë vendin gjatë muajit qershor 2017, të cilat grafikisht paraqiten në figurën Nr. 4.




Figura Nr. 4. – Vlerat për temperaturën mesatare mujore të ajrit për disa prej vendmatjeve meteorologjike të Sistemit Kombëtar të Monitorimit Meteorologjik.

Ndërkohë, vlerat e temperaturave të ajrit në mesditë shënuan gjatë këtij muaji vlera mjaft të larta, por pa thyer rekordet e mëparshme. Të dhënat meteorologjike për temperaturat maksimale absolute të vrojtuar gjatë muaj qershori 2017 (në °C) paraqiten në figurën Nr. 5, ku veçohet vlera +41.5°C e vrojtuar në Peqin. Vlerat e amplitudës së temperaturave të ajrit shënuan rritje gjatë muajit qershor kundrejt normës.




Figura Nr. 5. – Vlerat për temperaturën maksimale absolute të ajrit për disa prej vendmatjeve meteorologjike të vrojtuar gjatë muajit qershor 2017.

Gjatë stinës së verës klima në hapësirën e vendit tonë në vitet e fundit, duhet thënë se po merr gjithnjë e më shumë nuanca dhe karakteristika të klimës subtropikale. Kjo pasqyrohet gjithashtu dhe me një numër në rritje të **netëve tropikale** apo rasteve me reshje më të shpeshta në orët e mesditës. Në veçanti në vijim trajtohen të dhënat për numrin e netëve tropikale; pikërisht ato raste, kur temperaturat e ajrit nuk zbresin poshtë vlerës së 20°C gjatë natës. Në tabelën Nr. 1 jepen të dhënat për këtë tregues për disa vendmatje si dhe në figurën Nr. 6, paraqitet ecuria e netëve tropikale ndër vite për vendmatjen meteorologjike të Tiranës.

Muaji	Qershor
Vendmatja	Netë Tropikale
Belsh	7
Benë (Shmil)	4
Çukë	1
Dajç Zadrimë	4
Fshat Klos	7
Gojan	2
Krujë	7
Orikum	6
Petrelë	5
Petresh	4
Tiranë	11

Tabela Nr. 1 – Të dhëna mbi numrin e netëve tropikale për disa vendmatje meteorologjike për muajin qershor 2017.




Figura Nr. 6. – Ecuria e netëve tropikale ndër vite (2002-2017) për muajin qershor, bazuar në të dhënat e vendmatjes meteorologjike të Tiranës, si dhe vlerat e normës referuar periudhës 1961-1990.

Reshjet gjatë muajit qershor shënuan rënie kundrejt normës dhe në tërësinë e tyre ndikuan negativisht në bilancin ujqor. Gjithashtu duhet thënë se ato arrijnë deri në rreth 28% të vlerave të normës, referuar periudhës shumëvjeçare 1961-1990. Të dhënat në fjalë për afro 1/3 e vendmatjeve të analizuar dhe përpunuara, pas kontrollit dhe verifikimit tekniko shkencor janë paraqitur në grafikun e dhënë në figurën Nr. 7.




Figura Nr. 7. – Të dhënat për vlerat e reshjeve të vrojtuar gjatë muajin qershor 2017 dhe vlerat respektive të normës.

Natyrisht, sasia e ulët e reshjeve u shoqërua dhe me vlera nën normë të treguesit të numrit të ditëve me reshje mbi $\geq 1.0\text{mm}$.

Të dhënat e këtij treguesi tregojnë vlera rreth 70% më pak se norma. Ato paraqiten për një sërë vendmatjesh meteorologjike në figurën Nr. 8.




Figura Nr. 8. – Të dhënat për vlerat e treguesit të ditëve me reshje ≥ 1.0 mm gjatë muajit qershor 2017 dhe vlerat respektive të normës.

Ndërkohë, duhet thënë se në disa vendmatje kryesisht në Ultësirën Perëndimore nuk u vrojtuan reshje. Në vijim në figurën Nr.9 paraqiten të dhënat e reshjeve maksimale 24 orëshe.





Figura Nr. 9. – Të dhënat për vlerat e reshjeve maksimale 24 orëshe të vrojtura gjatë muajit qershor 2017.

Situata meteorologjike që karakterizoi muajin qershor 2017 konfirmohet në shkallë më të gjërë dhe nga treguesi i anomalive të reshjeve të evidentuar dhe në shkallë kontinentale, i paraqitur në figurën Nr. 10, ku konfirmohet e njëjta situatë dhe për vendin tonë.

Figura Nr.10.- Anomalitë e reshjeve në shkallë kontinentale për muajin qershor 2017.

Nga pikëpamja klimatike duhet evidentuar dhe një fakt i rëndësishëm që ka të bëjë me avullimin. Gjatë muajve të verës për shkak të temperaturave të larta të ajrit dhe të sipërfaqes së tokës, vlera e avullimit ditor në vendin tonë arrin deri në 5 mm në ditë.


Kësisoj në një klimë relativisht më të ngrohtë e pa reshje bilanci hidrik bëhet gjithnjë e më shumë negativ. Aq më tepër theksohet kjo dukuri, kur ajo pason disa muaj rresht, kur reshjet kanë shënuar vlera nën normë (shih Buletinet Klimatike të muajve të mëparshëm).



VLERËSIME MBI SITUATËN METEOROLOGJIKE TË PRITSHME PËR MUAJT NË VIJIM.

TEMPERATURA E AJRIT - Muajt korrik dhe gusht në tërësinë e tyre karakterizohen me vlerat më të larta vjetore të temperaturës së ajrit. Në vijim në figurën Nr. 11 jepet dhe një paraqitje grafike e vlerave absolute të shënuara ndër vite në vendmatjet e ndryshme meteorologjike. Ndonëse në vitet e fundit është vërtetuar në tërësi një mot më i ngrohtë dhe me temperatura mesatare mujore të ajrit mbi normë, duhet thënë se vlerat e këtyre temperaturave maksimale absolute, ende në shumicën e vendmatjeve nuk janë thyer. Rekordi vijon të ngelet **+43.9°C**, i vërtetuar më 18 korrik 1973 në Kuçovë.

Figura Nr. 11 – Paraqitje grafike e vlerave të temperaturës maksimale absolute të vërtetuara deri më sot, referuar tërë historisë së këtyre vendmatjeve meteorologjike.



Nga vlerësimet e qendrave kryesore profesionale meteorologjike ndërkombëtare mundësohet në figurat Nr. 12 dhe Nr. 13 një informacion mbi probabilitet e kategorive më të mundshme të temperaturave të ajrit për kontinentin europian; të cilat evidentojnë një situatë me vlera mbi normë për muajt korrik gusht dhe shtator, për hapësirën e vendin tonë.












Figura Nr.12. - Parashikimi i probabiliteteve të temperaturave të ajrit për muajt korrik, gusht dhe shtator 2017.

Ndërkohë, me interes duket situata e pritshme për një pjesë të madhe të hapësirës të gadishullit Ballkanit, gadishullit Apenin, duke përfshirë dhe një pjesë të mirë të Mesdheut qendror, në të cilat priten vlera të temperaturave të ajrit nën normë për muajt tetor, nëntor dhe dhjetor 2017.

Figura Nr.13. - Parashikimi i probabiliteteve të temperaturave të ajrit për muajt tetor, nëntor dhe dhjetor 2017.



RESHJET ATMOSFERIKE - Bazuar në modele të ndryshme të parashikimit të anomalive të reshjeve dhe referuar periudhës 1981-2010, në vijim në figurat 13/1-13/6 jepen disa rezultate për muajt në vijim. Vendi ynë në veçanti përfshihet me mundësi më të mëdha për reshje në muajin gusht dhe shtator dhe çka bën të veçantë është fakti se muajt më me reshje nëntor dhe dhjetor sipas karakteristikave klimatike të Shqipërisë rezultojnë të jenë me më pak reshje të pritshme për 2017. Kjo dukuri është konfirmuar dhe më parë për muajt dhjetor të vitit 2015, ku në të gjithë vendin nuk pati reshje duke shënuar një rekord në historinë e vrojtimeve meteorologjike, ashtu si dhe në dhjetor të vitit 2016, kur pati vetëm pak reshje, në të shumtën e rasteve nën 10 mm për gjithë muajin.



Figurat Nr. 13/1-13/6 – Parashikimi i anomalive të reshjeve për muajt: VII-XII 2017.

INFORMACIONE TË TJERA

Kur është koha më e përshtatshme për udhëtime turistike, për të vizituar një qytet në Shqipëri apo kudo në botë ?

Treguesi Klimatik Turistik për qytetin e Elbasanit

Në ditët e sotme turizmi është bërë ndër industritë më të mëdha ekonomike të botës. Klima paraqitet si një ndër parametrat kryesorë në zhvillimin e kësaj industrie. Kërkimet në këtë fushë kanë bërë që shumë prej vendeve të rajonit dhe pothuajse të gjithë vendet e Mesdheut ti japin rëndësi vlerësimit të treguesve të caktuar të klimës. Natyrisht edhe në vendin tonë studime të tilla marrin rëndësinë e vet. Qyteti i Elbasanit ka peshën e vet në lëvizjen e fluksit turistik apo dhe si destinacion turistik, prandaj vlerësimi i treguesit klimatik për turizmin për këtë qytet paraqet rëndësi të veçantë.

Treguesi Klimatik Turistik është një tregues shkencor, që merr përsipër të na njohë me evidentimin e periudhës kohore kur kushtet klimatike janë më të përshtatshme për lëvizjen turistike. Në këtë përlllogaritje peshë kryesore merr gjetja dhe përcaktimi i periudhave kohore kur kushtet e motit apo ato klimatike ofrojnë një shkallë rehatie apo komforti dhe produktiviteti të veprimtarisë njerëzore me vlera më të larta. Ky tregues është vlerësuar dhe pasqyruar në vijim për qytetin e Elbasanit. Studimet në këtë fushë bazohen në përdorimin e të dhënave klimatike përkatëse, referuar normave klimatike 1961-1990 si dhe zbatimit të metodologjisë së autorit Mieczkowski. TKT - Treguesi Klimatik Turistik (TCI - Turistic Climatic Index) është përdorur për herë të parë në vitin 1985 nga Mieczkowski (Universiteti i Monitobës) për të diskutuar dhe vlerësuar rolin e klimës në turizëm. Vlerësimi i TKT bëhet nëpërmjet zbatimit të formulës në vijim: $TKT=2[(4 \times TKD) + TKD + (2 \times R) + (2 \times D) + E]$, ku: *TKD*- treguesi i komfortit gjatë ditës, *TKD*-treguesi i komfortit 24 orësh, *R* – reshjet mujore, *D* – diellzimi, *E* – shpejtësia e erës.

Pas grumbullimit, përpunimit, verifikimeve të nevojshme dhe kontroleve tekniko-shkencore të bazës me të dhëna klimatike, përfundimisht arrihet të evidentohen ato periudha të vitit, ku treguesi klimatik turistik është më i lartë. Rezultatet janë paraqitur në tabelën në vijim Nr.2. Muajt janar, shkurt dhe dhjetor kanë treguesin më të ulët. Kushtet klimatike të kësaj periudhe kohore të vitit janë më të pafavorshmet për komfortin human si dhe po ashtu për lëvizjen turistike. Periudha tjetër e muajve: mars, prill dhe muaji nëntor në stinën e vjeshtës kanë një tregues klimatik të pranueshëm dhe të mirë në aspektin e lëvizjes turistike. Periudha e vitit me treguesit më të lartë ku komforti human dhe TKT marrin



Muaji	TKT	Kodi	Përshkrimi
Janar	33.0	3.0	E pafavorshme
Shkurt	48.0	4.0	Kufizuese
Mars	56.0	5.0	E pranueshme
Prill	65.0	6.0	E mirë
Maj	85.0	8.0	E shkëlqyer
Qershor	83.0	8.0	E shkëlqyer
Korrik	79.0	7.0	Shumë mirë
Gusht	71.0	7.0	Shumë mirë
Shtator	83.0	8.0	Shkëlqyer
Tetor	73.0	7.0	Shumë mirë
Nëntor	54.0	5.0	E pranueshme
Dhjetor	42.0	4.0	Kufizuese

vlerën shkëlqyer janë muajt maj, qershor dhe shtator. Përsa i përket muajve më të nxehtë të vitit, korrik dhe gusht treguesi zbret paska dhe merr vlerë shumë të mirë. Kjo ndodh si pasojë kryesisht e temperaturave të larta. Në këtë kategori përfshihet dhe muaji tetor. Rrjedhimisht del se Elbasani ka një tregues klimatik turistik, që e vlerëson klimën përkatëse me një potencial të lartë nga pikëpamja turistike në periudhën më të madhe të vitit. Ky potencial natyrisht me ndryshimet përkatëse është i pranishëm dhe në pjesën tjetër të vendit. Prandaj është e nevojshme që ky tregues të studiohet edhe më tej për të gjithë vendin, që më pas duke marrë në konsideratë rezultatet e përfuara dhe aplikuar në formën e duhur në politikat dhe strategjitë përkatëse për zhvillimin e sektorit turistik, të synohet që përfitimet të jenë sa më të mëdha për ekonominë në tërësi.

Kjo tematikë është trajtuar si pjesë e temës së diplomimit të studentit Gazmir ÇELA të degës Histori-Gjeografi në Fakultetin e Shkencave Humane të Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", nën udhëheqjen e Prof.Dr. Petrit ZORBA (Mbrojtur më datë: 10.07.2017).

Për të lexuar buletinet e tjera jeni të mirëpritur të vizitoni faqen përkatëse, duke klikuar në link-un e IGJEUM-it.



<http://www.geo.edu.al>



☀ ☀ ☀
Ky “Buletin Mujor Klimatik” u përgatit nga
Departamenti i Klimës dhe Mjedisit të
IGJEUM-UPT.
Tiranë © 2017.

